



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. Akti 568

Nr. 341 Vendimi  
Tiranë, më 1.2.2021

### V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

<b>Suela Zhegu</b>	Kryesuese
<b>Alma Faskaj</b>	Relatore
<b>Etleda Çiftja</b>	Anëtar

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Denisa Kosta, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Gerrit Sprenger, në datën 1.2.2021, ora 14:00 në Pallatin e Koncerteve, salla B, kati 0, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket,

**SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:** **Z. Henrik Ligori**, ish-prokuror pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, aktualisht pedagog i Shkollës së Magjistraturës.

**OBJEKTI:** **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

**BAZA LIGJORE:** **Neni G i Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar;

**Ligji nr. 96/2016**, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë“, neni 64, pika 1, germa “a”;

**Ligji nr. 44/2015**, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

**Ligji nr. 49/2015**, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

## TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, znj. Alma Faskaj, mori në shqyrtim dhe analizoi provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, si dhe shqyrtoi dhe analizoi çështjen në tërësi,

### V Ë R E N:

#### I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Subjekti i rivlerësimit, z. Henrik Ligori, ushtron aktualisht detyrën e pedagogut të brendshëm në Shkollën e Magjistraturës, pasi ka ushtruar detyrën e prokurorit deri në datën 3.7.2018.

2. Me vendimin nr. 1, datë 20.6.2020, trupi gjykues shprehu mospasjen e konfliktit të interesit, si dhe caktoi kryesuesin e tij.

3. Në datën 22.11.2020, subjektit të rivlerësimit iu dërguar përbërja e trupit gjykues dhe pyetësori standard, si dhe ju kërkua deklarimi i konfliktit të interesit.

4. Në datën 8.12.2020, subjekti në rrugë elektronike i ka kërkuar Komisionit ndër të tjera se: “*Unë nuk ushtroj më detyrën e prokurorit, ndaj nuk e gëzoj cilësinë e subjektit të rivlerësimit kalimtar. Për rrjedhojë, nuk mund të jem subjekt i nenit 179/b të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe ligjit nr. 84/2016, ‘Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë’.* Kërkesa ime për t’iu nënshtruar këtij procesi si ish-prokuror, sipas paragrafit 4 të nenit 179/b të Aneksit, duket se nuk gjen zbatim, pasi në çastin e hyrjes në fuqi të normave të sipërcituara, unë e gëzoja statusin dhe ushtrroja efektivisht funksionet e prokurorit pranë ish-Prokurorisë për Krimet e Rënda Tiranë ...”.

5. Me vendimin nr. 2, datë 27.1.2021, trupi gjykues vendosi mbylljen e hetimit administrativ.

6. Me vendimin nr. 3, datë 28.1.2021, trupi gjykues vendosi kalimin në seancë dëgjimore.

7. Subjekti i rivlerësimit është njoftuar në datën 28.1.2021, për datën dhe zhvillimin e senacës degjimore. Nëpërmjet postës elektronike, subjekti konfirmoi pjesëmarrjen e tij në këtë seancë dëgjimore.

8. Në datë 31.1.2020 (ditë e dielë), subjekti i është drejtuar në mënyrë elektronike Komisionit ku është shprehur se: “*...me e-mailin e datës 28.1.2021 konfirmova pjesëmarrjen time në seancën degjimore të datës 1.2.2021, në orën 14:00, nisur nga ideja se kjo seancë ishte e detyrueshme. Pasi u konsultova me ligjin dhe praktikën administrative, me anën e këtij e-mail-i, shpreh vullnetin tim se një seancë të tillë do të ishte e panevojshme, pasi raporti i rezultateve të hetimit është i qartë dhe i saktë dhe gjykoj se nuk mbetet ndonjë fakt që do të duhej të sqarohet në seancë*”, duke bashkëngjitur një dokument ku parashtron ndër të tjera se:

“*... u njoha me gjetjet e raportit mbi rezultatet e hetimit administrativ të hartuar nga ana Juaj, si dhe me dokumentacionin bashkëlidhur dosjes. Dëshiroj të konfirmoj se analizën dhe përfundimet Tuaja i gjej të drejta, logjike, mbështetura në ligje dhe në faktet të provuara nga hetimi.*

*Me aktin e dorëheqjes të datës 3.7.2018 unë zgjedha opsionin e ushtrimit të detyrës së pedagogut të brendshëm të Shkollës së Magjistraturës, pa afat të kufizuar, sipas dispozitave rregulluese që parashikon neni 264 i ligjit nr. 115/2016, ‘Për organet e qeverisjes së sistemit*

*të drejtësisë', duke u dorëhequr për këtë shkak nga detyra e prokurorit. Opsionin e komandimit të përkohshëm, që normon neni 265 i ligjit në fjalë dhe ruajtjen e statusit, e gjykova jorealiste, për shkak të moshës, i bindur se nuk kishte shumë kuptim rikthimi në sistem pas pesë vjetësh ndërprerjeje, për të ushtruar detyrën e prokurorit, për rreth një vit, deri në daljen në pension.*

*Me anën e kësaj letre, Ju konfirmoj edhe njëherë vullnetin tim të plotë për zgjedhjen e kryer me aktin e dorëheqjes së datës 3.7.2018, duke kërkuar ndërprerjen e procesit administrativ të rivlerësimit, pa qenë nevoja që të zhvillohet një seancë dëgjimore...”.*

9. Komisioni në datën 1.2.2021 hapi seancën dëgjimore dhe rivlerësoi kërkesën e re të subjektit të rivlerësimit.

## **II. Arsyetimi i Komisionit**

10. Subjekti i rivlerësimit, z. Henrik Ligori, ushtron aktualisht detyrën e pedagogut të brendshëm në Shkollën e Magjistraturës, pasi ka ushtruar detyrën e prokurorit deri në datën 3.7.2018.

11. Z. Henrik Ligori, nga marsi i vitit 1993 ka ushtruar detyrën e hetuesit dhe të oficerit të policisë gjyqësore në seksionin e prokurorisë. Me Dekretin nr. 3363, datë 5.6.2002, të Presidentit të Republikës është emëruar prokuror pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Me Dekretin nr. 4083, datë 6.1.2004, të Presidentit të Republikës është emëruar prokuror pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, detyrë të cilën e ka ushtruar deri në datën 3.7. 2018.

12. Për shkak të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të prokurorëve dhe gjyqtarëve në Republikën e Shqipërisë”, z. Henrik Ligori, në momentin e hyrjes në fuqi të këtij ligjit, duhej t’i nënshtrohej procesit të rivlerësimit, *ex officio*, dhe në bazë të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ka dërguar dhe plotësuar, si vijon:

- a. plotësimi dhe dërgimin e deklaratës së pasurisë, sipas shtojcës 2, të ligjit nr. 84/2016, në ILDKPKI, brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi e ligjit nr. 84/2016, sipas nenit 31;
- b. plotësimi dhe dërgimin e deklaratës për kontrollin e figurës, sipas shtojcës 3, të ligjit nr. 84/2016, në Drejtorinë e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi e ligjit nr. 84/2016, sipas nenit 35;
- c. plotësimi dhe dërgimin e formularit të vetëvlerësimit profesional, sipas shtojcës 4, të ligjit nr. 84/2016, pranë organit të vlerësimit të aftësive profesionale, brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi e ligjit nr. 84/2016, sipas nenit 41.

13. Me vendimin nr. \*\*\*, datë 4.7.2018, të Prokurorit të Përgjithshëm, “Për mbarimin e emërimit”, është vendosur mbarimi i emërimit të prokurorit Henrik Ligori, sipas Dekretit nr. 3363, datë 5.6.2002, të Presidentit të Republikës.

14. Z. Henrik Ligori, në datën 4.7.2018, i është drejtuar Komisionit me kërkesë për t’u vetuar në statusin e ish-prokurorit. Trupi gjykues i gatshëm pranë Komisionit, i ngritur për të shqyrtuar kërkesat për dorëheqje të subjekteve, të cilët gëzonin statusin e subjekteve të ligjit nr. 84/2016, por që nuk ushtronin më detyrën për shkaqe të ndryshme, ka vlerësuar këtë kërkesë, por nuk ka disponuar me vendim, duke çmuar dhe duke e shprehur në rrugë zyrtare elektronike, se subjekti duhet të shortohet dhe duhet t’i nënshtrohet procesit të rivlerësimit. Për

pasojë, subjekti i rivlerësimit, z. Henrik Ligori, është shortuar në qershor të vitit 2020. Pas shortimit, subjektit i është dërguar përbërja e trupit gjykues, si dhe pyetëtori standard.

15. Në përgjigje të e-mail të dërguar, subjekti i është përgjigjur në kohë pyetëtorit dhe më pas ka dërguar në rrugë elektronike një kërkesë, se nuk duhet të vetohet dhe se procesi i tij duhet të ndërpritet, pasi nuk gëzon statusin e magjistratit për shkak të dorëheqjes në datën 3.7.2018.

Konkretisht, subjekti citon: “... me anën e njoftimit elektronik të datës 22.11.2020, u njoha me faktin se Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ka filluar procesin e rivlerësimit kalimtar të personit tim, në përputhje me nenin 179/b të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe me ligjin nr. 84/2016, ‘Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë’.

Më lejoni t’ju njoftoj se me vendim nr. 24, datë 28.6.2018, të Këshillit Drejtues të Shkollës së Magjistraturës së Republikës së Shqipërisë jam emëruar në detyrën e pedagogut të brendshëm të kësaj shkolle. Duke qenë se emërimi im në këtë detyrë nuk ishte një komandim i përkohshëm, sipas nenit 265 të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, në datën 3.7.2018 i kam paraqitur Prokurorit të Përgjithshëm dorëheqjen nga detyra e prokurorit (dokument bashkëlidhur).

Me vendim nr. \*\*\*, datë 4.7.2018, Prokurori i Përgjithshëm vendosi mbarimin e emërimit tim në detyrën e prokurorit dhe ndërprerjen e marrëdhënieve financiare, duke filluar nga data 3.7.2018 (dokument bashkëlidhur).

Lidhur me sa më sipër, nga data 3.7.2018, unë nuk ushtroj më detyrën e prokurorit, ndaj nuk e gëzoj cilësinë e subjektit të rivlerësimit kalimtar. Për rrjedhojë, nuk mund të jem subjekt i nenit 179/b të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe ligjit nr. 84/2016, ‘Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë’. Kërkesa ime për t’iu nënshtruar këtij procesi si ish-prokuror, sipas paragrafit 4, të nenit 179/b, të Aneksit, duket se nuk gjen zbatim, pasi në çastin e hyrjes në fuqi të normave të sipërcituara, unë e gëzoja statusin dhe ushtroja efektivisht funksionet e prokurorit pranë ish-Prokurorisë për Krimet e Rënda Tiranë”.

16. Në vijim të procesit, në lidhje me subjektin e rivlerësimit, z. Henrik K. Ligori, Komisioni iu drejtua zyrtarisht institucioneve, si vijon:

- ❖ Këshillit të Lartë të Prokurorisë me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 11.12.2020, duke i kërkuar informacion nëse, z. Henrik Ligori, gëzon statusin e magjistratit në zbatim dhe në kuptim të ligjit nr. 96/2016, “Mbi statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”?

Këshillit të Lartë të Prokurorisë me shkresën nr. \*\*\*prot., datë 21.12.2020, protokolluar në Komisioni me nr\*\*\*, datë 23.12.2020, citon si vijon:

“Pas verifikimit të dokumenteve që disponohen në Sektorin e Burimeve Njerëzore, z. Henrik Ligori, nuk e gëzon statusin e magjistratit në zbatim dhe në kuptim të ligjit nr. 96/2016, ‘Për stastusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë’, pasi është larguar nga detyra me vendimin nr. \*\*\*, datë 4.7.2018, të Prokurorit të Përgjithshëm”.

Me vendimin nr. \*\*\*, datë 4.7.2018, të Prokurorit të Përgjithshëm, “Për mbarimin e emërimit”, është vendosur mbarimi i emërimit të prokurorit Henrik Ligori sipas Dekretit nr. 336, datë 5.6.2002, të Presidentit të Republikës.

- ❖ Prokurorisë së Përgjithshme me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 11.12.2020, kërkesë për kopje të dokumentacionit të dorëheqjes për prokurorin Henrik K. Ligori. Prokuroria e Përgjithshme me shkresën nr. \*\*\*prot., datë 17.12.2020, na vë në dispozicion kopje të dokumentacionit të dorëheqjes së z. Henrik Ligori.
- ❖ Shkollës së Magjistraturës me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 11.12.2020, kërkesë për kopje të dokumentacionit të emërimit në detyrën e pedagogut të brendshëm pranë Shkollës së Magjistraturës z. Henrik K.Ligori. Shkolla e Magjistraturës me shkresën nr. \*\*\*prot., datë 17.12.2020, na vë në dispozicion kopje të dokumentacionit të emërimit në detyrën e pedagogut të brendshëm në Shkollën e Magjistraturës të z. Henrik Ligori, ku pjesë e dokumentacionit është edhe vendimi nr. 24, datë 28.6.2018, “Për emërimin e z. Henrik Ligori pedagog i brendshëm në Shkollën e Magjistraturës”.

17. Komisioni, gjatë hetimit të kësaj çështjeje, i është drejtuar institucioneve për të sqaruar juridikisht çështjet, si vijon:

1. A gëzon, z. Henrik Ligori, statusin e magjistratit në funksionin që ka sot si pedagog i brendshëm në Shkollën e Magjistraturës ?
2. A është, z. Henrik Ligori, subjekt i ligjit nr. 84/2016, si subjekt *ex officio*, apo si ish-prokuror apo gjyqtar?
3. Vendimi i Prokurorit të Përgjithshëm që disponon për mbarimin e emërimit të z. Henrik Ligori, si prokuror mund të konsiderohet si vendim për mbarimin e statusit të magjistratit si pasojë e dorëheqjes së tij?
4. Cilat janë pasojat e një dorëheqje nga statusi i magjistratit në procesin e rivlerësimit?

18. Komisioni çmon se në analizë të dokumentacionit të administruar gjatë hetimit rezulton se z. Henrik Ligori, duke ushtruar funksionin si pedagog i brendshëm në Shkollën e Magjistraturës, referuar edhe procedurave të ndjekura për emërimin e tij, nuk gëzon statusin e magjistratit.

Në bazë të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes në sistemin e drejtësië”, konkretisht, Neni 264

### **Zgjedhja dhe emërimi i pedagogëve, përgjegjësve për programet e trajnimit dhe kancelarit**

“1. *Pedagogët e brendshëm dhe të jashtëm emërohen nga Këshilli Drejtues me propozim të drejtorit ose të anëtarëve të Këshillit Drejtues, pas një procesi transparent e gjithëpërfshirës të bazuar në meritë dhe në një proces konkurrues.*

2. *Pedagogët e brendshëm zgjidhen nga radhët e juristëve më të shquar me eksperiencë mbi 15-vjeçare si juristë, gjyqtarë, prokurorë, avokatë dhe me eksperiencë mësimdhënëse si pedagogë të brendshëm në sistemin universitar ose si pedagogë të jashtëm e të brendshëm në Shkollën e Magjistraturës, me eksperiencë mbi 10 vjet.*

3. *Pedagogët e brendshëm gëzojnë të gjitha të drejtat dhe privilegjet e gjyqtarit të gjykatës së apelit*”.

Nenit 265

### **Pedagogët gjyqtarë ose prokurorë**

*“1. Këshilli Drejtues i Shkollës së Magjistraturës mund t’i kërkojë Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë që gjyqtarë ose prokurorë në detyrë të komandohen si pedagogë të brendshëm në Shkollën e Magjistraturës, bazuar në procedurën e përcaktuar në ligjin nr. 84/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.*

Për sa më sipër, procedura e emërimit të z. Henrik Ligori, nuk ka qënë ajo e parashikuar në nenin 265 dhe fakti që subjekti sot është pedagog i brendshëm referon se këta të fundit gëzojnë të drejtat dhe privilegjet e gjyqtarit të Gjykatës së Apelit dhe jo statusin e gjyqtarit të apelit.

### **19. Lidhur me statusin e magjistratit**

Neni 65, i ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ka parashikuar procedurën që duhet ndjekur për mbarim të statusit të magjistratit nëpërmjet dorëheqjes, si vijon: “1. *Magjistrati mund të kërkojë mbarimin e statusit, nëpërmjet paraqitjes së dorëheqjes para Këshillit përkatës. 2. Dorëheqja duhet të jetë me shkrim dhe nuk është e nevojshme të jetë e arsyetuar. Dorëheqja jep efektet në fund të muajit pasardhës, nga dita kur Këshilli merr deklarin me shkrim të dorëheqjes. Mbarimi i statusit të magjistratit deklarohet me vendim të Këshillit jo më vonë se dy javë nga mbarimi i statusit*”.

20. Komisioni çmon se rezultoni e provuar se në rastin konkret subjekti ka kërkuar dorëheqjen nga detyra dhe, për pasojë, edhe nga statusi i magjistratit dhe kjo kërkesë i është drejtuar Prokurorit të Përgjithshëm për shkak se ende nuk ishte konstituuar Këshilli i Lartë i Prokurorisë. Me vendimin nr. \*\*\*, datë 4.7.2018, të Prokurorit të Përgjithshëm në pikën 2 të tij është shprehur: “*Miratimin e mbarimit të emërimit të prokurorit Henrik Ligori sipas Dekretit të Presidentit nr. 3363, datë 5.6.2002*”, dhe bazë ligjore është pika 1 e nenit 64, pikërisht, mbarimi i statusit për shkak të dorëheqjes. Ky qëndrim bazohet, gjithashtu, në jurisprudencën e Kolegjit të Posëm të Apelit.

Në vendimin nr. 1/2018, të Kolegjit të Posëm të Apelit në pikën 97, citohet: “*Kolegji i Posëm i Apelit orienton Komisionin që për zgjidhjen e çështjeve, duke respektuar parimin e transparencës në zhvillimin e procedurës së rivlerësimit, të verifikojë vullnetin e pavesuar për dorëheqjen e dhënë, e cila duhet të ketë burim të ligjshëm një prej institucioneve të caktuara me ligj: (i) Presidenti i Republikës; (ii) Këshilli i Lartë i Drejtësisë (deri në komstituimin e tij Këshilli i Lartë Gjyqësor); dhe (iii) Këshilli i Lartë i Prokurorisë (deri në komstituimin e tij Prokurori i Përgjithshëm). Si sanksion kushtetues për raste të ngjashme, Komisioni orientohet që përveç ndërprerjes së procesit të rivlerësimit, të vendosë edhe ndalimin e emërimit të subjektit të rivlerësimit gjyqtar ose prokuror të çdo niveli, anëtar të Këshillit të Lartë Gjyqësor ose të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor të Lartë të Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm për një periudhë 1- vjeçare*”.

21. Pavarësisht se subjekti nuk ka kërkuar dorëheqjen nga statusi i magjistratit, por dorëheqje nga detyra e prokurorit, këto të dyja janë të lidhura me njëra-tjetrën, pasi nuk mund të kesh statusin nëse ti nuk ke detyrën, përveç rasteve kur ushtron një funksion të komanduar, që në

rastin konkret nuk ka ndodhur. Kjo gjë, pra, mbarimi i statusit të magjistratit duket se konfirmohet edhe nga KLP-ja, e cila vlerëson se juridikisht vendimi i Prokurorit të Përgjithshëm është vendimi që ka deklaruar mbarimin e statusit të magjistratit në rastin konkret.

22. Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka shfrytëzuar të drejtën që i njeht Kushtetuta për dorëheqje dhe mos vijimin e procesit të rivlerësimit për shkak të dorëheqjes së subjektit të rivlerësimit, e cila sjell si pasojë përfundimin e kësaj procedure administrative dhe, si rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit humbet të drejtën për t'u emëruar gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit G, të Aneksit të Kushtetutës,

### **PËR KËTO ARSYE,**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar, në pikën 2, të nenit G, të Kushtetutës, si dhe të nenit 57 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, në bazë të nenit 64 të ligjit nr. 94/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurëve",

### **V E N D O S I:**

1. Të deklarojë ndërprerjen e procesit të rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit, z. Henrik Ligori.
2. Të deklarojë humbjen e së drejtës për t'u emëruar gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare.
3. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
4. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
5. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 1.2.2021.

### **KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT**

**Suela ZHEGU**

**Kryesues**

**Etleda ÇIFTJA**

**Anëtar**

**Alma FASKAJ**

**Relatore**